



Pranuar / Dorezuar Prenjeno / Prodato Received / Delivery	07-10-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Dr. Prot. Dr. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	5989/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.767/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.767/2021 të datës 05.09.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] përfaqësuar me autorizim nga Avokat [redacted] me adresë: [redacted] Komuna e Mitrovicës, kundër Vendimit Nr.02/2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të datës 18.08.2022, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.767/2022 të datës 05.09.2022, të parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

Ankuesit [redacted] i punësuar në Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me datë 09.05.2022 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 3134/2022 të regjistruar me numër A.nr.767/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.02/2022 të datës 18.08.2022 të Komisionit Disiplinor në Thesarin e Kosovës, përmes të cilit vendim ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore "Largim nga Marrëdhënia e Punës", për shkak të shkeljes së rëndë disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3, nën paragrafi 3.10 dhe 3.17 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi, kundër Vendimit Nr.02/2022 të datës 18.08.2022 të Komisionit Disiplinor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se Komisioni Disiplinor shqiptimin e masës disiplinore nuk ka e ka bazuar në fakte dhe masa nuk është në proporcion me dëmin e shkaktuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.09.2022, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë të Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa me datë 20.09.2022 ka pranuar provat e kërkuara të lëndës nga Njësia Përgjegjëse e MFPT-së.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me numër protokoll 5134/2022 të datës 05.09.2022 me shkresat e bashkangjitura; Autorizimin e datës 01.09.2022; Vendimin Nr.02/2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve i datës 18.08.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 12.09.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 20.09.2022; Akt emërimit e ankuesit i datës 02.04.2014; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën vozitës në Ministrinë e Financave/Thesari; E-mailin e datës 27.07.2022 dërguar nga A.I për XH.Z me korrespondencën e bashkangjitur prej tre (3) faqesh; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 27.07.2022; Vendimin pezulluese të datës 27.07.2022 të nxjerrë nga Komisioni Disiplinor; Shkresën e datës 28.07.2022 dërguar nga S.K për Xh.Z; Foto me materiale shpenzuese - pako me letër; Shkresën e datës 28.07.2022 me numër:3022-KB-158.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi **sepse:**

Kolegji i Këshillit bazuar në provat e lëndës, respektivisht Shkresën e Emërimit të datës 02.04.2014 ka konstatuar se ankuesi **mban pozitën e punës "Vozitës"** në Njësinë - Administratë dhe TI, në kuadër të Thesarit/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Kolegji i Këshillit lidhur me kompetencën lëndore të Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 2 paragrafi 3 ku përcaktohet se: **3 Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë, dhe paragrafin 6 të të njëjtit nen ku përcaktohet se: 6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike", dhe si rrjedhojë duke u bazuar edhe në përshkrimin e detyrave të punës të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se pozita "Vozitës" hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës, respektivisht ankuesi sipas pozicionit që mbanë nuk e ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil.**

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil si dhe duke marrë parasysh konstatimin se ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.767/2022 të datës 05.09.2021 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në dispozitat e nenit 24 paragrafi 4 ndërlidhur me nenin 2 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, udhëzon palën ankuese për ushtrimin e mjeteve juridike fillimisht të Komisioni i Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publikë dhe Nëpunësit Tekniko - Administrativ pranë punëdhënësit dhe më pas mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.767/2022

Flakron GASHI


Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës/MFPT-së;
- Udhëheqësit të Personelit në Thesarin e Kosovës/MFPT-së;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

